



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 tetor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1603_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike;
- Vendimin për NQ Termokos SH.A., Nr. V_1602_2022 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR); dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH.A., për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike (Ngrohjes), të dorëzuar me datë 27 korrik 2022, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues,

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2022/2023.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos sh.a., për sezonin e ngrohjes 2022/2023 është dhënë në tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos SH.A. – sezoni 2022/2023:

TARIFAT E ENERGIJË TERMIKE TË NQ TERMOKOS - Sezoni 2022/2023			
A: TARIFAT E ENERGIJË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.78	
Tarifa për Fumizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	36.25	
B: TARIFAT E ENERGIJË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.11	0.14
Tarifa për Fumizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.65	0.81
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.76	0.95



- III. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale lidhur me matjen e furnizimit/konsumit të energjisë termike, tarifat e përcaktuara në dispozitivin nën pikën II. të këtij Vendimi zbatohen për faturim për rastet tipike si në vijim:
- Për objektet, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe që janë në pronësi ose në shfrytëzim të një konsumatori, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1.A
 - Për objektet e banimit kolektiv që janë në pronësi ose në shfrytëzim të disa konsumatorëve, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore në objekt mundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1A.
 - Për objektet, nënstacionet e të cilëve nuk janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe për objektet e përshkruara nën pikën (2) në të cilat instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore pamundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim do të zbatohen tarifat “normative”, sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorit, – Tabela 1B.
- IV. NQ Termokos sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën 1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos, për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A., duke filluar nga data e fillimit të sezonit të ngrohjes 2022/2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27 korrik 2022 nga NQ Termokos SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave të energjisë termike, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkëngjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike, të datës 27 korrik 2022;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 12 gusht 2022, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkëngjitur me kërkesën e datës 27 korrik 2022;
 - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos SH.A., me datë 19 gusht 2022;
 - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2022/2023;
 - Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (21 shtator – 05 tetor 2022);



- Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
- Raportin Final: Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2022/2023; dhe
- Raportin final për Përcaktimin e Tarifave të Energjisë Termike për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2022/2023.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Rejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së